



Agjencia e Akreditimit e Kosovës
Kosovo Accreditation Agency
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 38 213-722
Fax:: +381 38 213-990
e-mail: kaaoffice@gmail.com
web: www.akreditimi-ks.org

Nr. 501113 dt. 08.07.2013

Në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr. 03/L-189), Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 04/L-037), neni 7 (pika 2.3 dhe pika 4), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e BPrAL (nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e AKA-së (nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 02/2013), në Udhëzimin Administrativ për Kriteret dhe Procedurën e Akreditimit të Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (nr. 12/2009), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim ka shqyrtuar raportet e ekspertëve të vlerësimit dhe në bazë të rekomandimeve, në mbledhjen e mbajtur më 3 Korrik 2013, mori:

V E N D I M

I. Akreditohet programi i studimit i Kolegjit “Riinvest”:

- Tregjet Financiare dhe Bankat (MA)
për një periudhë 3 vjeçare (1 Tetor 2013- 30 Shtator 2016).

II. Programi i studimit:

- Ekonomiks Menaxherial, Menaxhment dhe Ndërmarrësi (PhD)
nuk akreditohet.

III. Institucioni i juaj është i obliguar që të hartojë një Plan të Përmirësimit në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve (në të dy gjuhët dhe në të dy versionet) dhe të njëjtin ta dorëzoni në Agjencinë e Kosovës për Akreditim gjer më 1 Dhjetor 2013.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ferdije Zhushi Etemi, kryetare
Këshilli Shtetëror i Cilësisë

